



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4/74  
Datë: 10/12/2021

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës me qëllim të zbatimit të UA 09/2021 aplikimi i pagesave të studentëve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Studentët e nivelit të studimeve bacheloret dhe master, të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë vijuar studimet, respektivisht nuk qenë aktiv në fakultet dhe dëshmohet se për vitet përkatëse nuk kanë marr asnjë shërbim nga fakulteti (ligjërata, kolokfiume, seminare apo provime), ndërsa si rrjedhojë e kësaj, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas Vendimit nr.4/185, dt. 26.11.2015, ndaj tyre janë krijuar obligime (semestra) të pa paguara deri në vitin akademik 2021/22, lirohen nga pagesa e semestrave në mënyrë retroaktive.
2. Lirimi nga pagesa i kategorisë së studentëve si në pikën 1 të këtij vendimi, nuk nënkupton rimbursimin e pagesave për studentët që i kanë kryer obligimet para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Studentët që i takojnë kategorisë si në pikën 1 të këtij vendimi, janë të obliguar që duke filluar nga viti akademik 2021/22, t'i kryejnë obligimet në përputhje me UA 09/2021 për aplikimin e pagesave të studentëve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë.
4. Duke filluar nga viti akademik 2021/22, lirohen nga pagesa e regjistrimit të semestrit për herën e parë studentët e kategorisë si në vijim:
  - 4.1. Studentët e rregullt, në nivelin –Bacheloret;
  - 4.2. Studentët në studimet në nivelin Master;
  - 4.3. Studentët e rregullt, në nivelin Bacheloret vetëm një vit pas dëgjimit të ligjëratarave të vitit të fundit të studimeve (statusi absolut);
  - 4.4. Studentët e doktoratës do të lirohen nga pagesat e semestrit të përsëritur, nëse përsëritja e semestrit është shkaktuar nga rrethanat jashtë kontrollit të studentit siç janë: vonesat në caktimin e mentorëve, në realizimin e punës hulumtuese ose në publikimin e rezultateve të punës hulumtuese sipas dëshmive përkatëse të njësisë akademike.
  - 4.5. Lirimi nga pagesa nga nën paragrafi 4.4 i këtij vendimi, do të bëhet për më së shumti dy semestra gjatë periudhës së studimeve, me vendim të organit kompetent të institucionit i cili mund të merret:
    - 4.5.1. Për individë, grupe ose kategori studentësh të doktoratës për të cilat ekzistojnë njohuri se i plotësojnë kushtet nga paragrafi 4.5 i këtij vendimi.
    - 4.5.2. Në bazë të kërkesës së argumentuar të studentit ose grupit të studentëve.
  - 4.6. Përjashtimet tjera nga obligimi i pagesës së tarifës së shkollimit dhe shërbimeve administrative të përcaktuara me nenet 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ 09/2021,

mund të realizohen vetëm në bazë të legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të veçanta të Këshillit drejtues.

5. Nga viti akademik 2021/22, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, nuk përfitojnë të drejtën e liritimit nga pagesa e semestrave obligative, studentët e kategorisë si në vijim:
  - 5.1. Studentët me korrespondencë në nivelin baçelor;
  - 5.2. Studentët në studimet e doktoratës;
  - 5.3. Studentët e të gjitha niveleve të studimeve të cilët e regjistrojnë semestrin për herë të dytë e më tepër, përjashtimisht kategorive që lirohen sipas legjislacionit në fuqi ose sipas vendimit të veçantë të Këshillit drejtues.
6. Duke filluar nga viti akademik 2021/22, studentët të cilët i ndërpresin studimet përkohësisht pa leje paraprake të dekanit të njësisë akademike siç përcaktohet në nenin 150, paragr. 5 të Statutit, nuk do të lirohen nga pagesa e semestrave pavarësisht lartësisë së borxhit të krijuar. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në përputhje me nenin 150, paragr. 5, nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve dhe rrjedhimisht nuk e obligon studentin që të paguaj semestrat për atë periudhë.
7. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Këshill Drejtues dhe do të zbatohet deri në një vendim tjetër.
8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 4/185, datë 26.11.2015.

### Arsyetim

Pas hyrjes në fuqi të UA nr. 09/2021, për aplikimin e pagesave të studentëve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, janë parashtruar kërkesa dhe ankesa të ndryshme nga studentët e tri niveleve të studimeve. Kërkesat kanë qenë kryesisht për lirim nga pagesat retroaktive të semestrave, me arsyetimin se në dy vitet e fundit ka qenë periudha e pandemisë dhe si pasojë studentët e nivelit të doktoratës e kanë pasur të pamundur ose të vështirësuar hulumtimin në laboratorë si dhe në marrjen e mostrave të ndryshme me pacientë, kafshë apo edhe plotësimin e pyetësorëve në gjykata, banka etj. Një numër i konsideruar i studentëve pa fajin e tyre nuk kanë arritur që të sigurojnë mentor për caktimin e temave të diplomës në tri nivelet e studimeve, dhe si rrjedhojë vonesa në diplomim i ka ngarkuar me obligime financiare, prandaj mbi këtë bazë Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Ky vendim t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Menaxhmentit të UP-së,
3. Dekanëve të njësive akademike,
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së,
5. Sekretarëve të njësive akademike,
6. Shërbimit të financave të UP-së.

  
Këshilli Drejtues i UP-së  
Dr. Sc. Arbesha Nela- Turjaka